

URDHËR
Nr. 2, datë 21.1.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; të urdhrit nr. 39, datë 5.2.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Komisionit të Prokurimit Publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Komisionit të Prokurimit Publik, znj. Irma Droboniku, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 21.1.2021 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
4. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në Buletinin e Njoftimeve Publike.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Jonaid Myzyri